



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:226303

Datë: 19.09.2023

Numri i dokumentit: 04691165

PPP.nr.1123/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, me gjyqtarin Blerand Rrmoku, në çështjen juridike përmbarimore ndërmjet kreditores “K.N” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, kundër debitorit L.I nga Prishtina, Rr. “H.T” nr..., lidhur me çështjen përmbarimore për përmbushjen e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori, kundër Urdhrit për lejimin e përmbarimit P.nr.392/21 të datës 23.06.2021, të lejuar nga Përmbaruesi Privat I.K në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 19.09.2023. mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i ushtruar nga debitori L.I nga Prishtina, ashtu që: ANULOHET Urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.392/21 i datës 23.06.2021, i lejuar nga Përmbaruesi Privat I.K në Prishtinë, si dhe REFUZOHET propozimi për përmbarim i paraqitur me datë 23.06.2021 nga kreditori “K.N” Sh.p.k, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat I.K në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “K.N” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.392/21, dt.23.06.2021, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të faturave: Nr. INV/2020/00674279, e datës 29.09.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2020/00750176, e datës 29.10.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2020/00822687, e datës 29.11.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2020/00896961, e datës 29.12.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00063537, e datës 29.01.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00131623, e datës 01.03.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00278712, e datës 29.04.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00324265, e datës 29.05.2021, në vlerë prej 9.99€ dhe faturës Nr. INV/2021/00359844, e datës 15.06.2021, në vlerë prej 19.99€ dhe vlerë të përgjithshme në shumë prej 99.91€, me të cilin ka theksuar se debitori në bazë të obligimeve të papaguara nga

fatura, brenda afatit 7 ditorë nga dita e dorëzimit të urdhrit përmbarimor, detyrohet t'ia paguajë kreditorit shumën prej 99.91€.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit të paraparë ligjor, prapësim ka paraqitur debitori. Në prapësimin e ushtruar, ndër tjera pretendohet se debitori ka trashëguar pajisjet prej një klienti të mëparshëm të kreditorit, dhe për shfrytëzimin e internetit për periudhën e muajit korrik 2020 ka bërë ndryshimin e emrit të kontratës së vjetër dhe ka bërë pagesë vetëm për një muaj të shërbimit të internetit në zyrën e kreditorit. Më tutje ka shtuar se në asnjë moment nuk ka kërkuar shërbim përtej 30 ditëve që specifikon edhe Kontrata ..., e bashkëngjitur si dëshmi nga kreditori, që qartazi specifikon shërbimin vetëm për periudhën prej 28.07.2020 deri me dt.27.08.2020. Tutje ka theksuar se debitori nuk ka qenë asnjëherë i lajmëruar nga kreditori për faturat dhe pretendimet të cilat janë bashkëngjitur si dëshmi në këtë urdhër përmbarimor, përkundër faktit që kontrata në nenin 9 parasheh që fatura duhet të dorëzohet mbi baza mujore me email, në shtëpi përmes postës, postës elektronike, etj. Më tej ka shtuar se kreditori me këtë rast po bën shkelje të të drejtave të konsumatorit, pasi që në rastin e mos - pagesës, automatikisht ndalet shërbimi, ndërsa në këtë rast, kreditori parashtron kërkesë për mjete për shërbim që nuk është realizuar asnjëherë, që nënkupton se nuk ka bazë për pagesë përderisa nuk ka pasë pranim të shërbimit, duke pretenduar se ky përmbarim është lejuar bazuar në një kontratë që debitorit nuk i është prezantuar si kontratë një vjeçare, si dhe disa fatura të cilat debitori asnjëherë nuk i ka pranuar nga kreditori. Po ashtu, pretendon se debitori nuk është lajmëruar fare nëpërmjet telefonit për borxhin e pretenduar nga kreditori, nuk ka pranuar ndonjë vërejtje për pagesë të borxhit para inicimit të procedurës përmbarimore siç përkon me zakonet e institucioneve kosovare por edhe në rrafshin e praktikave të mira të industrisë private në kujdesin ndaj klientëve dhe konsumatorit. Bazuar në këto pretendime, ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë prapësimin si të bazuar dhe ta hedhë poshtë urdhrin përmbarimor.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, duke propozuar që Urdhri për Lejimin e Përmbarimit të mbetet në fuqi dhe prapësimi të refuzohet në tërësi si i pabazuar. Në përgjigjen e parashtruar ndër tjera pretendohet se kontrata e hartuar nga kreditori, të cilën ka pasur rast ta lexojë debitori para se ta nënshkruajë është në përputhje të plotë me Rregulloren e ARKEP nr.38 për "Kontratën, Transparencën dhe Publikimin e Informatave dhe Masave tjera Mbrojtëse për Përdoruesit Fundorë për Ofrimin e Rrjetëve dhe Shërbimeve Publike të Komunikimeve Elektronike", e cila në nenin 5.7 përcakton që: "Ndërmarrësi mund të kërkojë kompensimin e dëmit për shkeljet e parakohshme të kontratës gjatë nëntë (9) muajve të parë kur kontrata është e lidhur për 12 muaj, respektivisht 12 muajve të parë kur kontrata është e lidhur për 24 muaj. Shuma e kompensimit të dëmit nuk mund të tejkalojë tarifën e parapagimit mujor për periudhën e mbetur prej nëntë (9) respektivisht 12 muajve pas hyrjes në fuqi të kontratës". Tutje pretendohet se debitori ka qenë i njoftuar lidhur me këtë pjesë, sepse e ka pasur të inkorporuar në kontratën të cilën vetë e ka nënshkruar, se ka qenë në dijeni që kontrata është (1) një vjeçare dhe nuk mund të shkellet dhe se në rast se debitori nuk i përmbushë obligimet e faturuara brenda shtatë (7) ditësh, autorizon kreditorin që të bëjë përmbarim të dhunshëm përmes Përmbaruesit Privat. Po ashtu, ka shtuar se debitori duke mos realizuar pagesa tek kreditori ka shkelur kontratën, edhe pse ai me nënshkrimin e kontratës ka qenë i njoftuar me faktin që kontrata në fjalë është kontratë një (1) vjeçare, është kontratë me faturim të përsëritshëm, që do

të thotë se debitori ka qenë i obliguar të paguajë në baza mujore dhe se kjo kontratë nuk mund të shkëputet në mënyrë të njëanshme, vetëm në rastet kur debitori pajtohet që të paguajë shumën për 9 muaj, respektivisht 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës. Bazuar në këto pretendime, ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.392/21, i datës 23.06.2021.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 29 par.1 e LPP-së përcakton llojet e dokumenteve të besueshme mbi bazën e të cilave mund të caktohet përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla, duke përcaktuar se: *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.3 faturat”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t'i përmbajë një dokument përmbarimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbarim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përmbarimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbarim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbarim është paraqitur duke u mbështetur në faturat si në vijim: Fatura Nr.INV/2020/00674279, e datës 29.09.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr.INV/2020/00750176, e datës 29.10.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2020/00822687, e datës 29.11.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr.INV/2020/00896961, e datës 29.12.2020, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00063537, e datës 29.01.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr. INV/2021/00131623, e datës 01.03.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr.INV/2021/00278712, e datës 29.04.2021, në vlerë prej 9.99€; Nr.INV/2021/00324265, e datës 29.05.2021, në vlerë prej 9.99€ dhe faturës Nr.INV/2021/00359844, e datës 15.06.2021, në vlerë prej 19.99€. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, faturat e lartëcekura janë dokumente të lëshuara në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe te njejtat nuk e përmbajnë nënshkrimin e pranuesit – debitorit, pra nuk konsiderohen fatura kthyese. Nisur nga një vlerësim i tillë, të njejtat fatura nuk i plotësojnë kushtet për të shërbyer si dokumente mbi bazën e të cilave mund të caktohet përmbarimi në kuptim të dispozitave nga nenet 29 par.1 nënpar 1.3 lidhur me nenin 27 par.1 të LPP-së, rrjedhimisht nuk e kanë cilësinë e dokumenteve të besueshme në kuptim të kësaj procedure.

Sipas nenit 43 par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin*

për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim". Mbi këtë bazë, gjykata në rastin konkret vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, sepse është lejuar përmbarrimi mbi bazën e dokumenteve të cilat nuk rezultojn të jenë pranuar nga ana e debitorit, andaj duke iu referuar dispozitës së lartëcekur, gjeti se pretendimet e parashtruara në prapësimin e debitorit janë të bazuara, rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes së kësaj çështje mori parasysh pretendimet e parashtruara nga ana e kreditorit në përgjigje në prapësim, në të cilat vihet theksi tek mospërmbushja e obligimeve kontraktuale nga ana e debitorit, e për të cilat pretendime Gjykata vlerëson se mund të adresohen përmes inicimit të procedurës kontestimore nga ana e palëve ndërgjyqëse. Kjo për faktin se procedura përmbarrimore udhëhiqet nga parimi i rigorozitetit formal, ku objekt vlerësimi është vetëm dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi, në kuptim të vlerësimit të përmbushjes së tipareve të cilat kërkohen me ligj në mënyrë që i njëjti të konsiderohet i përshtatshëm për përmbarrim. Në këtë kuptim, Gjykata vë në dukje faktin se posedimi i një dokumenti – fature, jo domosdoshmërisht paraqet bazë të mjaftueshme për të realizuar kërkesën në procedurë përmbarrimore, pasi për realizimin e një kërkesë të tillë duhet plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore me dispozitat e lartëcekura nga nenet 29 par.1 nënpar 1.3 lidhur me nenin 27 par.1 të LPP-së, kushte këto të cilat në rastin konkret nuk janë përmbushur, për çka Gjykata erdhi në përfundim se çështja duhet vendosur në këtë mënyrë.

Nga arsyet e elaboruara më sipër, në bazë të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
PPP.nr.1123/21 datë 19.09.2023

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.